

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, të mbajtur më 24.11.2023, duke shqyrtuar mbi Konkluzionin e Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të nxjerrë në takimin e punës, të mbajtur në tetor 2021, në përputhje me nenin 101 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nenit 37 paragrafi (1) të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrta e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.58/2006...96/2019), miratoi si vijon:

## Mendim juridik parimor

Afati prej 30 ditëve për paraqitjen e kërkesës për ngritjen e procedurës përkundërvajtje, të përcaktuar në nenin 83 paragrafi (4) të Ligjit përkundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RMV" numër 96 të datës 17.05.2019) është afat instruktiv dhe si pasojë nuk mund të ketë hedhje poshtë të kërkesës që është parashtruar pas skadimit të atij afati, duke u thërritur në dispozitën ligjore të nenit 87 paragrafi (2) pikë 5 të Ligjit përkundërvajtje.

Arsy etim

Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 31.01.2022 diskutoi mbi Konkluzionin e përfaqësuesve të gjykatave të apelit dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të nxjerrë në takimin e punës, të mbajtur në tetor 2021, për harmonizimin e praktikës gjyqësore, mbi çështjen juridike: “Vallë afati prej 30 ditëve për paraqitjen e kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje sipas nenit 83 paragrafi (4) të Ligjit për kundërvajtje (“Gazeta zyrtare e RMV” nr.96 të datës 17.05.2019), është afat përfundimtar dhe si pasojë ka hedhjen e kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje pas skadimit të atij afati apo ai afat është vetëm afat instruktiv, dhe është dedikuar për parashtruesin që sa më shpejtë me përditësim dhe në afat të arsyeshëm t'i paraqesë kërkesat për kundërvajtje në organet kompetente”, në mënyrë që nxori Konkluzion, me të cilin përcaktoi se ekzistojnë vendime të ndryshme në nivel të gjykatave të apelit dhe veprim të ndryshëm nga gjykatat e apelit, në mënyrë që propozoi mbi këtë çështje të diskutojë Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sa i përket kësaj çështjeje juridike një pjesë e gjykatave kanë marrë vendim me të cilat kërkesat janë të hedhura poshtë respektivisht procedurat për kundërvajtje janë ndërprerë për arsy që është përcaktuar se nga momenti i konstatimit të kundërvajtjes me procesverbal nga një organ kompetent, deri në momentin e kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në organin kompetent, kanë kaluar 30 ditë. Duke u thërritur në dispozitat e nenit 83 paragrafi (4), në lidhje me nenin 87 paragrafi (2) të Ligjit për kundërvajtje, këto gjykata vendimet për ndërprerjen e procedurës i kanë themeluar në bazë të dispozitave nga neni 115 paragrafi (2) të Ligjit për kundërvajtje, duke llogaritur se afati prej 30 ditëve është afat përfundimtar, që si pasojë ka pamundësi për ngritjen e procedurës respektivisht udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje.

Në anën tjetër, gjykatat e apelit të rajoneve të Shkupit dhe Shtipit në vendimet e tyre, konstatojnë se afati prej 30 ditëve për paraqitjen e kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, sipas dispozitave të nenit 83 paragrafi (4) dhe neni 58 paragrafi (2) dhe (8), dhe në lidhje me nenin 86 dhe 87 të Ligjit për kundërvajtje, nuk është përfundimtar përkatësisht i detyrueshëm dhe është orientues, dhe ka të bëjë vetëm me organizimin e mirë të brendshëm për paraqitësit e kërkesave, që të njëjtat të parashtronen në organin kompetent në një afat të arsyeshëm dhe për atë shkak si pasojë nuk kanë sanksion, që do të shprehej me hedhjen poshtë të kërkesës apo ndërprerjen e procedurës së kërkesës së parashtruar.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme këto fakte i përcaktoi nga këqyrja në lëndët e katër gjykatave të apelit.

Për shkak të veprimit të tillë të ndryshëm të gjykatave, gjykatat e apelit në takimin mbi harmonizimin e qëndrimeve, të mbajtur në tetor 2021, kanë nxjerrë Konkluzion, “Afati prej 30 ditëve për paraqitjen e kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje nga neni 87 paragrafi (4) të Ligjit për kundërvajtje është afat instruktiv, respektivisht se pas konstatimit të kundërvajtjes, me lëshimin e tij nuk humbet e drejta për marrjen e një veprimi të caktuar, siç kryesisht veprohet edhe gjatë parashtrimit të propozim akuzës, sepse nuk ka dispozitë në Ligjin për kundërvajtje, që parashikon pasojë nga mosveprimi i atij afati, siç është përcaktuar në dispozitat e Ligjit për procedurë penale. Në këtë takim është ra në dakord që ky Konkluzion të zbatohet deri kur Gjykata Supreme të prononcohet lidhur mbi këtë çështje.

Sipas nenit 2 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje (“Gazeta Zyrtare e RMV” numër 96 të datës 17.05.2019, që zbatohet nga 25.05.2019), për kundërvajtjen dhe përgjegjësinë e kundërvajtjes zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat e një pjesë të përgjithshme të Kodit penal.

Sipas nenit 41 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje, Procedura e kundërvajtjes nuk mund të ngrihet as të udhëhiqet nëse kalojnë dy vjet nga dita kur është kryer kundërvajtja.

Sipas nenit 41 paragrafi (10) të Ligjit për kundërvajtje, Parashkrimi për ndjekjen e kundërvajtjes shkaktohet në çdo rast kur kalon dy herë aq kohë sa sipas ligjit kërkohet për parashkrim të ndjekjes për kundërvajtje.

Sipas paragrafit 11 nga i njëjtë nen, Afati i parashkrimit nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, mund të jetë më i gjatë nëse në sferë të caktuar kryhet harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Sipas nenit 58 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje, Organi për kundërvajtje ngre procedurë për kundërvajtje me detyrë zyrtare ose me kërkesë nga personi i autorizuar në organet nga neni 83 paragrafi (2) të këtij Ligji.

Sipas nenit 58 paragrafi (2), Personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar në afat sa më të shkurtër të mundshëm jo më gjatë se 30 ditë nga dita e konstatimit të kundërvajtjes ose pas kallëzimit të ngritur për kundërvajtje të kryer, të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes çdo herë kur ekziston bazë ligjore për atë, kur është e konfirmuar me mjete teknike ose me kallëzim të personit të dëmtuar.

Sipas paragrafit (8) nga i njëjtë nen, Organi për kundërvajtje me aktvendim do ta hedh poshtë kërkesën për ngritjen e procedurës për kundërvajtje sipas neneve 86 dhe 87 të këtij Ligji.

Sipas nenit 83 paragrafi (1), Procedura e kundërvajtjes ngritët me kërkesë të organit të autorizuar.

Sipas nenit 83 paragrafi (4), Organet e autorizuara nga paragrafi (2) i këtij neni janë të detyruar në afat prej 30 ditëve nga dita e konstatimit të kundërvajtjes ose pas paraqitjes së kallëzimit nga i dëmtuari për kundërvajtje të kryer të paraqesin kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, çdoherë kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer kundërvajtje.

Sipas paragrafit (5) të këtij neni, Nëse afati nga paragrafi (4) ka kaluar ose nëse është marrë njoftimi se kërkesa është e pabazë, i dëmtuari ka të drejtë të parashtrojë kundërshtim te organi më i lartë kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes në punën e organit nga paragrafi (2) i këtij neni, vendimi i të cilit është përfundimtar.

Sipas nenit 87 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje, Nëse gjykata konstaton se nuk ekzistojnë kushte për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, kërkesën do ta hedh me aktvendim.

Sipas paragrafit (2) të këtij nenit, Nuk ka kushte për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kur: veprimi i përshkruar në kërkesë nuk është kundërvajtje, ekzistojnë baza që e përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtje, ka ndodhur parashkrim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, kërkesën e ka paraqitur një parashtrues, respektivisht një person i paautorizuar, ekzistojnë arsyet tjetra ligjore për të cilat procedura për kundërvajtje nuk mund të ngritet, kërkesa nuk është shoqëruar me prova për kundërvajtje të kryer, kërkesa nuk i përmban të dhënat e nevojshme nga nenit 84 i këtij Ligji.

Sipas nenit 115 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje, Procedura e kundërvajtjes ndërpritet me aktvendim, nëse: i akuzuari ka vdekur, personi juridik ka pushuar të ekzistojë, gjykata përcakton se kundërvajtja është kryer në gjendje të paparamenduar, gjatë rrjedhjes së procedurës te personi i akuzuar është shkaktuar sëmundje e përhershme mendore dhe në raste të caktuara me këtë ligj.

Sipas paragrafit (2) të këtij nenit, Procedura e kundërvajtjes do të ndërpritet edhe në raste tjetra të caktuara me ligj.

Nga dispozitat e cituara ligjore dhe arsyetimet e gjykatave të apelit që konsiderojnë se ky afat është instruktiv, në mënyrë që duke marrë parasysh institutin parashkrim për ngritjen e procedurës dhe udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje, të shënuar në nenin 41 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje, si dhe dispozitat e nenit 87 paragrafi (2), Seanca e përgjithshme përcaktoi qëndrimin e thënë në Mendimin juridik parimor.

Gjatë përcaktimit të këtij qëndrimi, Seanca e përgjithshme është udhëhequr nga dispozitat e sipër theksuara të Ligjit për kundërvajtje, duke analizuar të njëjtat krahasuar me Ligjin për procedurë penale, sa i përket kategorive proceduese të caktuara, sidomos kuptimi dhe kategorizimi i afateve, krahasuar edhe me literaturë përkatëse juridike. Në interes të këtij qëndrimi është edhe sqarimi i kaluar i kuptimit të përgjithshëm të nocioneve të caktuara që ndikojnë për përcaktimin e karakterit të afateve respektivisht vallë ato afate janë instruktive apo përfundimtare.

Sipas argumentimit të theksuar juridik Seanca e përgjithshme miratoi Mendimin juridik parimor në fjalë.

Shkup, 08.12.2023

Seanca e përgjithshme e  
Gjykatës Supreme të  
Republikës së Maqedonisë së Veriut